



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 279/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazic dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 500 (pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi

Arsyetim

Me datën 09.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, ku thekson se më dt. 08 qershor 2014 kandidati për Kuvend të Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së Luan Gola, ka bërë thirrje përmes rrjetit social Facebook që të votohet LDK, nr. 54. Sipas parashtruesit të ankesës kandidati në fjalë ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 7.1 pika b i Rregullës Zgjedhore 11/2013, Kodin e Mirësjelljes për Subjektet politike neni 36.1 i pikës b të LZP-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se si kandidati për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, Luan Gola, në rrjetin e tij social facebook ka bërë thirrje për votuesit që të votojnë LDK konkretisht numrin e tij 54, me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik LDK është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit dhe bërja fushatë në çfarëdo mënyre ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja fushatë në çfarëdo mënyre, veprime këto që e bëjnë përgjegjëse dhe kanë ndikuar në caktimin e lartësisë së gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 36.1 pika a), lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

A nr. 279/2014 më datën 11.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*